
Dienststelle Volksschulbildung

Sie mund ta ndihmoj unë fëmijën tim në mësimin e matematikës

Të menduarit matematikor ashtu si mësimi i të folurit dhe ecjes është pjesë e zhvillimit fëmior.

Aftësitë matematike janë njohja e numrave, njohja e formave, orientimi në hapësirë, perceptimi i vetëdijshëm i mjedisit dhe veprimtarive, veprimet me numrat dhe format.

Ju si prindër mund ta ndihmoni fëmijën tuaj në rrugën e matematikës, në qoftë se ju i merrni serioisht pyetjet e tija, zhvilloni biseda me fëmijën dhe e stimuloni për të bërë veprime vetë.

Fëmija mëson veprimtari të ndryshme matematikore në situatat e jetës së përditshme

Përfshijeni me vetëdije fëmijën tuaj në proceset e përditshme:

- Lëreni të mbulojë tavolinën. Ne jemi 6 vetë për të ngrënë. Peceta paloset – nga një katërkëndësh krijohet një trekëndësh.
- Gatvani bashkë me fëmijën dhe flitni mbi këtë: Neve na duhen 4 vezë, 200 g sheqer, 1 lugë kripë.
- Lejojeni ta ndajë një mollë në dy gjysma, pastaj secilën gjysmë ta ndajë në dy gjysma të tjera, ta ndajë në salçiçe në riska, të mbushë një fixhan me qumësht etj.
- Gjatë blerjes lejojeni fëmijën të paguaj shuma të vogla.
- Lejojeni të shtypë numrat e telefonit.
- Gjatë festave të ditëlindjeve flitni mbi moshat e ndryshme të fëmijëve.
- Stimulojeni fëmijën për veprime të tilla si të ndajë në mënyrë të drejtë një grusht me rrush të thatë, një qese me arra ose një zemer çokollate.

Fëmija pyet për numrin, madhësinë dhe intervalin kohor.

Kërkoni së bashku një zgjidhje ose drejtoni vetë pyetje të tilla:

- Sa gurë janë këtu? Sa yje janë në qiell? Sa Cornflakes-a ka në kuti?
- Sa e lartë është kjo pemë? Sa peshon ti? Sa ujë zë vaska?
- Sa e vjetër është kjo pemë? Edhe sa kohë duhet deri te ditëlindja ime?

Fëmija numëron

Kushtoni vazhdimisht vëmendje rasteve të numërimit:

- Ka ardhur dikush për vizitë – sa persona janë?
- Sa dritare ka ndërtesa?
- Numëroni guaskat e mbledhura të kërmillave/midhjeve.
- A mundesh t'i sjellësh 3 molla, të lutem?

Fëmija tregon historira, grimca humoristike, përjetime

Fëmija përdor veprime matematike në lojë

- Lojra me zare, si p.sh. «Eile mit Weile» («Mos u nxeh»), «Leiterli-Spiel» («loja me shkalla»), e kështu me radhë.
- Sa të ka rënë numri i zarit?

Fëmija i pëcepton gjatë punës së dorës format dhe trupat

Flitni së bashku gjatë punës së dorës mbi veprimet, format dhe trupat (si p.sh. rreth, trekëndësh, katërkëndësh, katror, kub, sferë, cilindër), të cilat krijohen gjatë prerjes, palosjes, ngjitjes dhe ngjeshjes:

- Nga një katror palosim një trekëndësh.
- Për çatinë e një kulle presim më parë një rreth.
- Formojmë sfera dhe kuba prej brumi me kripë.
- Me materiale të mbetura, si p.sh. me kartonin cilindrik së letrës së WC-së, kutija kartonit, e kështu me radhë, ndërtojmë makina.

Fëmija ndërton dhe konstrukton në mënyrë të lirë me kuba ndërtimit, kuba Lego, shina trenit

Vëni në dispozicion vend për këto gjëra. Fëmija duhet të mund të ndërtojë sipas fantazisë së tij të lirë si dhe të mund të ndërtojë makina dhe ndërtesa sipas planesh.

- Kush ndërton kullën më të lartë?

Fëmija mëson të njohë vëllimet

Lejojeni fëmijën tuaj të merret me ujë, të hapë gropa për krijimin e liqeneve në vendin e rërës, të ndërtojë tubacione (mund të bëhen edhe me tubat e pirjes), të mbushë enë dhe të ndihmojë gjatë pjekjes.

Fëmija orjentohet në hapësira të mëdha

Flitni me fëmijën gjatë rrugës ku dhe në cilin drejtim është çfarë në atë moment:

- Ku është shtëpia e jonë? Ku është tashmë stacioni i trenit?
- A e din se në cilin drejtim është qyteti?
- Mbas një shëtitjeje, kërkoni rrugën në hartë.
- Të shihen planet e vendit të vet: Ku banojmë ne?

Fëmija nuk duhet të mësojë të llogarisë përmendësh. Është e nevojshme të ketë një përfytyrim të numrave dhe veprimeve matematike. Për të kuptuar më mirë ndihmojnë shumë shembujt me sende konkrete, lojrat e roleve mbi situatat dhe **biseda** mbi atë çfarë bëhet.

Lucern, 25. Mai 2020

275848